



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.12.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti DPKI-06-4465/22-A, për zyrtarin e lartë z. Gani Kastrati, Anëtar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për shkak se:

- a) nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit;
- b) është shmangur gjendja papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për z. Gani Kastrati, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

a) Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit lidhur me zyrtarin e lartë publik z. Gani Kastrati, Anëtar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (në vijim: KPMM) pasi që, siç është theksuar në raportimin e rastit, i njëjti krahas pozitës si më lartë ka edhe marrëdhënie të rregullt pune me një institucion privat të arsimit të lartë në Kosovë. Tutje në raportimin e rastit është theksuar se në bazë të Ligjit për KPMM, Bordi (i këtij Komisioni) është i llojit ekzekutiv dhe zyrtarët nuk janë të lejuar të mbajnë pozita të rregullta në të dy vendet.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) me shkresën zyrtare DPKI-06-02/4494/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Gani Kastrati lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç'rast z. Gani Kastrati është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket dyshimit për konflikt të interesit.

Në takimin e mbajtur dhe përmes dokumentacionit të dorëzuar në Agjenci, z. Gani Kastrati ka sqaruar dhe ka paraqitur argumentet e tij sa i përket dyshimit për konflikt të interesit në lidhje me të qenurit mësimdhënës në një institucion privat të arsimit të lartë. I njëjti ka theksuar se me këtë institucion është në marrëdhënie pune vetëm si mësimdhënës - profesor dhe se nuk

mbanë ndonjë pozitë menaxheriale. Lidhur me këtë z. Gani Kastrati ka paraqitur dëshmi (DPKI-06-02/4494-1/22), ashtu që në bazë të Vendimit të institucionit privat të arsimit të lartë nr. 3198, i datës 15.03.2021, konstatohet se zyrtari në fjalë zgjedhet Profesor Asistent në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë dhe Inxhinierisë së Bujqësisë dhe Mjedisit, ndërsa sipas Vërtetimit të institucionit privat të arsimit të lartë nr. protokolli 10795/43-01, i datës 01.09.2021, vërtetohet se z. Gani Kastrati është në marrëdhënie pune me institucionin në fjalë në cilësinë e Stafit Akademik i Rregullt.

Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike si më lartë, sa i përket faktit se z. Gani Kastrati, krahas funksionit publik që ushtron si Anëtar i Bordit të KPMM-së, është edhe mësimdhënës - profesor në një institucion privat të arsimit të lartë në Kosovë, Agjencia konstaton se me dispozitat e LPKI-së (në parim) nuk parashihet ndonjë ndalesë apo kufizim, me të cilën nuk i lejohet zyrtarit të lartë publik, në rastin konkret Anëtarit të Bordit të KPMM-së, që të ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin e mësimdhënësit - profesorit në një institucion privat të arsimit të lartë.

Për më tepër, dispozita e nenit 10 [Ushtrimi i punëve tjera nga zyrtari] paragrafi 2, e LPKI-së, përcakton se: *“Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje të tjera”*. Sipas kësaj dispozite, parimisht, zyrtari gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Anëtar i Bordit të KPMM-së, mund të ushtrojë punë nga lëmi i arsimit, në këtë rast si mësimdhënës - profesor në një institucion privat të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me ligje të tjera.

Në kontekst të asaj sikurse përcaktohet me fjalinë e fundit të dispozitës së nenit 10, paragrafi 2, të LPKI-së (*“nëse nuk parashihet ndryshe me ligje të tjera”*), nëse me legjislacionin për KPMM-në dhe legjislacionin për zyrtarët publik (ligje të tjera) derivon ndonjë kufizim dhe/apo ndalesë (eventuale) me të cilën, siç është pretenduar, nuk u lejohet anëtarëve të Bordit të KPMM-së mbajtja e dy pozitave të rregullta të punës, kjo trajtohet dhe zgjidhet nga institucionet përkatëse të cilat kanë mandat për interpretimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni, sepse interpretimi i legjislacionit për KPMM-në dhe legjislacionit për zyrtarët publik, si dhe zbatimi i kufizimeve dhe/apo ndalesave (eventuale) të përcaktuara me këtë legjislacion, janë jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë.

b) Agjencia gjatë trajtimit të rastit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar se z. Gani Kastrati, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik - Anëtar i Bordit të KPMM-së, njëkohësisht është edhe përfaqësues i autorizuar në biznesin privat “Gani S. Kastrati” B. I. (DPZ “Gan-Dizajn”).

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se: *“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”*.


Në takimin e mbajtur, z. Gani Kastrati është njoftuar për kufizimet ligjore sa i përket të qenurit përfaqësues i autorizuar në biznes privat, krahas funksionit si zyrtar i lartë publik, si dhe është udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik. I njëjti është pajtuar me gjetjet e Agjencisë duke pranuar se është përfaqësues i autorizuar i biznesit si më lartë dhe ka premtuar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete, në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar informatën (DPKI-06-02/4494-1/22) me të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznesin privat, duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit tek një person tjetër (personi i besuar). Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Gani Kastrati, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.5, lidhur me nenin 15 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

